



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:117864

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06214664

K.DH.SH.K.II.nr.891/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtarja individuale Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “A...M...” Shpk me NUI:..., me seli në Magjistratën Prishtinë Shkup, kundër debitorit “B...” Shpk me seli në rr. ...” p.n. Vushtri me NUI: ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.Z., avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023, jashtë seancës me datë 20.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si e pa bazuar ankesa e kreditorit “A...M...” Shpk, me seli në Magjistratën Prishtinë Shkup e datës 25.10.2023 dhe ankesa e debitorit “B...” Shpk me seli në Vushtri, e datës 25.10.2023 ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerçiale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023, nën pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propësimin e debitorit “B...” Shpk, dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrit Përmbarimor P.NR.071/23 të datës 13.02.2023 të Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 431.2€ (katërqind e tridhjetë e një euro e njëzet cent), sipas faturës nr. 20-SHV01-L-85 të datës 28.01.2020, faturës nr. 21-SHV01-S-5478 të datës 16.09.2021 dhe faturës 22-SHV01-S-6991 të datës 30.09.2022. Në pikën II. Refuzohet pjesërisht si i pa bazuar propësimi i debitorit “B...” Shpk, dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.071/23 i datës 13.02.2023 të Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj sa i përket shumës prej 932.49€ (nëntëqind e tridhjetë e dy euro e katër dhjetë e nëntë cent), sipas faturës nr. 21- SHV01-S-2642 të datës 11.05.2021, faturës nr. 21- SHV01-S-3134 të datës 03.06.2021, faturës nr. 21- SHV01-S-4403 të datës 30.07.2021, faturës nr. 22-SHV01-S-1093 të datës 03.03.2022 dhe faturës nr. 22-SHV01-S-2869 të datës 12.05.2022 së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%. Në pikën III. përfundohet pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “A...M...” Shpk ndaj debitorit “B...” Shpk, sipas urdhrit P.nr.071/23 të datës 13.02.2023 për shumën prej 431.20€ (katërqind e tridhjetë e një euro e njëzet cent), sipas faturës nr. 20-SHV01-L-85 të datës 28.01.2020, faturës nr. 21-SHV01-S-5478 të datës 16.09.2021 dhe faturës 22-SHV01-S-6991 të datës 30.09.2022.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit A...M... Shpk me numër të regjistrimit të biznesit ... dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023 i Gjykatës Komerçiale Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërkaq të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor i përmbaruesit privat P.nr.071/23 i datës 13.02.2023 dhe të detyrohet debitori që të paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës përmbarimore deri në përfundim të detyrimit të tij.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore. Me propozim që të aprovohet ankesa e

debitorit “B...” Shpk me seli në rrugën “...” p.n. në Vushtrri, me numër unik identifikues ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat, L.Z., me numër të licencës ... me numër personal ... me seli në rrugën ... Prishtinë. Të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës me nr. KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023 ashtu që të anulohet në tërësi Urdhri P.nr.071/23 për lejimin e përmbarimit i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Rrezarta Metaj dhe rrjedhimisht refuzohet në tërësi propozimi për përmbarim i kreditorit “A...M...” Shpk, me numër unik Identifikues ..., me seli në rrugën “Magjistrallja Prishtinë-Shkup”.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, duke kundërshtuar ankesën e kreditorit dhe duke argumentuar se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, në aktvendimin e ankimuar e ka nxjerrë duke zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjithashtu ka bërë vërtetim të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike, gjithashtu debitori paraqet prova se detyrimi ndaj kreditorit është përmbushur në tërësi përmes konkluzionit me numër protokoll P.nr.071/2023 i datës 30.11.2023, andaj ka propozuar që të hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e kreditorit “A...M...” Shpk me numër Unik Identifikues ... me seli në rrugën Magjistrallja Prishtinë Shkup, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me nr.KPPP.nr.390/23 të datës 05.09.2023 dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë me numër KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023.

Gjyqtarja individuale i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore të kreditorit dhe të debitorit, si dhe përgjigjen në ankesë të debitorit në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “A...M...” Shpk me seli në rrugën Magjistrallja Prishtinë Shkup me datë 04.05.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “B...” Shpk me seli në Vushtrri, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave dhe të detyrohet “B...” Shpk me numër të regjistrimit të biznesit Nr. UID ..., NRB ... dhe me numër fiskal NRF: ... dhe adresë Rr. ..., që t’ia paguaj Kreditorit borxhin në shumë prej 1363.69€, me kamatë ligjore prej 8% duke

filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturave e gjer në pagesën definitive të borxhit kryesor dhe kamatës si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore duke u ekzekutuar: 1. Ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogarinë e veçantë të përbaruesit privat. 2. Përbarimin mbi letrat me vlerë dhe pjesët në shoqëritë tregtare, përmes regjistrimit të aksioneve në pronësi të debitorit dhe të letrave me vlerë në shoqëritë tregtare, si dhe kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në një kompani aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore të biznesit. 3. Regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që nga shitja e realizuar të përmbushet dhe shlyhet borxhi kryesor i debitorit: kamata ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat Rrezarta Metaj duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lejuar përbarimin me urdhrin P.nr.071/2023 të datës 13.02.2023, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 27.02.2023, duke theksuar se debitori i ka përmbushur në tërësi obligimet ndaj kreditorit si dhe faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përbarimor nuk kanë tipare të përbarueshmërisë. Gjykata supreme përmes aktvendimit CML.nr.24/2017 të datës 17.01.2018 lidhur me përshtatshmërinë për përbarim të faturave ka përcaktuar standardin sipas të cilës faturat duhet të jenë të mbështetura në kontrata përkatëse, duhet të jenë të pranuar/nënshkruara nga personat kompetent si dhe të njëjtat duhet të jenë të vulosura. Dokumentet e besueshme në bazë të së cilave është lejuar përbarimi nuk i përmbajnë elementet e domosdoshme të cilat i parasheh ligji. Neni 29 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën Përbarimore parasheh se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Me theks të veçantë duhet cekur faktin se faturat e bashkangjitura propozimit për përbarim dhe në bazë të së cilave është lëshuar Urdhri Përbarimor P.nr.071/23 nuk janë të pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që po ti shikojmë faturat e bashklidhura asnjëra nga to nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, pasi që të njëjtat nuk janë të protokolluara nga debitori, duke qenë se pranë debitorit është zyra e arkivimit dhe me rastin e dorëzimit të faturave do të i vendosje vula e protokollimit dhe të njëjtat do të ishin të pranuar në mënyrë të rregullt. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit B... Shpk me seli në Vushtrri, të Anullohet Urdhri P.nr. 071/23 për lejimin e përbarimit të lëshuar nga përbaruesi privat Rrezarta Metaj me datë 13.02.2023, pranuar nga debitori me datë 16.02.2023

rrjedhimisht të refuzohet propozimi për përbarim i kreditorit A...M... Shpk me seli në fshatin Preocë, Prishtinë. Të obligohet Kreditori A...M... Shpk, me seli në fshatin Preocë, Prishtinë, që debitorit B... Shpk me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat L.Z., të ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore dhe atë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për prapësimin e ushtruar shumë prej 156.00€ 9 njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro).

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike pas vlerësimit të prapësimin, dhe përgjigjes në prapësim ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.390/23 i datës 05.09.2023, ka vendosur që ta pranoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm-përkatësisht faturën nr. 21- SHV01-S-2642 të datës 11.05.2021, faturës nr. 21- SHV01-S-3134 të datës 03.06.2021, faturës nr. 21- SHV01-S-4403 të datës 30.07.2021, faturës nr. 22-SHV01-S-1093 të datës 03.03.2022 dhe faturës nr. 22-SHV01-S-2869 të datës 12.05.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori janë përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8% dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilën përcaktohet se debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton përmes borxhit kryesor edhe kamatën dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përbarimor edhe sa i përket kësaj pjese për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumë prej 932.49€, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatë vonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive. Andaj në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore me të cilin përcaktohet se “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose

pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera” gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e Dhomës së Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç janë faturat, për shumën e detyrimit prej 932.49 Euro, dhe se të njëjtat janë të përshtatshme për përmbarim pasi që përmbajnë të gjitha kërkesat nga neni 29 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 2 të LPP-së, si dhe të njëjtat janë të pranuar në mënyrë të rregullt.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit të paraqitura në ankesë lidhur me atë se gjykata në mënyrë të unifikuar dhe sipërfaqësore pa marrë fare mundin që të elaboroj apo arsyetoj bazën e vendimit të saj përveç tjerash edhe e ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore në shumën prej 431.20€ e këtë duke u thirrur në dispozitën e nenit 12 par 2 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshim plotësim të Ligjit 04/L-139. Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se kreditori në këtë lëndë juridike përmbarimore nuk ka ofruar prova që vërtetojnë se fatura me nr. 20-SHV01-L-85 e datës 28.01.2020, fatura nr. 21-SHV01-S-5478 e datës 16.09.2020 dhe fatura nr. 22-SHV01-S-6991 e datës 30.09.2022 janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, pra nuk është dëshmuar se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori pasi që nuk janë të nënshkruara

ose të vulosura nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk kanë qenë të përshtatshme për përmbarim, po ashtu i njëjti as në Urdhrin Përmbarimor e as në ankesë nuk ka bashkangjitur fakte që do të dëshmonin të kundërtën, andaj vlerësimin e Dhomës së Shkallës së Parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e sheh si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, sepse faturat në fajlë janë të nënshkruar dhe të pranuar nga debitori dhe se pretendimet e tilla nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj edhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formal të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi. Andaj, nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.891/24 datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri